

Zhvillohen në KLSH sesionet e punës me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë në fushën e IT dhe të auditimeve në Industrinë Nxjerrëse

27-31 janar 2025

Në kuadër të planit të përbashkët të aktiviteteve në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë, u zhvilluan në KLSH përgjatë javës 27 - 31 janar 2025, sesionet e punës me ekspertët përkatës në fushat e IT dhe të auditimeve në Industrinë Nxjerrëse.

Sesionet e punës në fushën e IT u zhvilluan në kuadër të workshopit me temë “**Test i penetrimit të brendshëm në KLSH**”, si një qasje praktike bazuar në kursin e zhvilluar mbi bazat e testimeve të sigurisë së informacionit.

Përzgjedhja e kësaj teme ka për qëllim përfitimin në disa drejtime duke përfshirë:

- Forcimin e sigurisë kibernetike;
- Kuptueshmërinë e mendësisë së hakerëve;
- Zhvillimin e strategjive mbrojtëse proaktive;
- Pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret e sigurisë;
- Mundësinë për rritje profesionale në fushën e sigurisë kibernetike, etj.

Në këtë aktivitet morën pjesë auditues të Departamentit të Auditimit IT, si dhe të Drejtorisë së IT në KLSH.

Workshopi ofroi përfitime të mëdha për pjesëmarrësit, duke rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre



reaguese në fushën e “Ethical Hacking” dhe “Cyber Security”. Nëpërmjet tij u mundësua përdorimi i teknikave të testimit të penetrimit të brendshëm, duke i mundësuar stafit të identifikojë, por dhe të zbusë rrisqet apo vulnerabilitetet potenciale, që mund të prekin sistemet dhe rrjetin e brendshëm të KLSH-së.

Përdorimi i materialeve praktike, si prezantime, skripte dhe simulime në mjedisin VMware, ofruan një mundësi për të praktikuar dhe zhvilluar aftësi konkrete, të cilat mund të aplikohen menjëherë në auditimin e sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturave nga KLSH. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e sigurisë dhe në forcimin e mbrojtjes ndaj kërcënimeve kibernetike, duke kontribuar në një rrjet më të sigurt dhe më të mbrojtur për KLSH-në.

Gjithashtu, në datat 28-30 janar 2025 u zhvillua workshopi mbi “Identifikimin e risqeve dhe auditimin në lidhje me menaxhimin e industrisë nxjerrëse të sektorit të naftës në Shqipëri”.

Workshopi u fokusua në vlerësimin e marrëveshjes hidrokarbure Patos Marinzë me kontraktor Bankers Petroleum sh.a dhe përgjatë ditëve të zhvillimit fokusi ishte në disa fusha kryesore, ndër të cilat:



- identifikimin e palëve të interesit që përfshihen në këtë marrëveshje dhe lidhjet mes tyre, të drejtat dhe detyrimet;
- evidentimin e risqeve përkatëse duke qartësuar çështjet për auditim bazuar në rëndësinë dhe materialitetin; qëndrimi i detyruar nga hapësira e madhe kohore, volumi i madh i çështjeve dhe informacioneve për t'u përpunuar, si dhe mundësia për akses;
- vlerësimin e hartimit të kontratës,

pikat e forta e të dobëta, si janë modelet e kontratave të praktikave më të mira;

- vlerësimi i gjendjes së pellgut Patos Marinzë në lidhje me kapacitetin e naftës së mbetur, si një çështje shumë e rëndësishme për vazhdimësinë e kontratës;
- vlerësimi i gjendjes së investimeve të kryera në vite, inventarizimi i tyre dhe përgatitja për marrjen në dorëzim nëse kontraktori nuk do të shfaqë interes për të vazhduar marrëveshjen hidrokarbure;
- ndikimi në mjedis i operacioneve hidrokarbure të kryera nga Bankers Petroleum;
- vlerësimi i humbjeve ose derdhjeve të naftës mbi ose nën tokë gjatë operacioneve hidrokarbure nëse janë në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuar të industrisë ndërkombëtare të naftës, etj;

Ky workshop u ndoq nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, i cili është dhe departamenti përgjegjës për këtë auditim.